

**SBASHK****Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures**

# Arsimimi

**KULTURA E NJERIUT***Ë-buletin***Tetor, 2020**

## Një aktivitet i veçantë i SBASHK-ut Përgatiten kuadro të reja për trajnerë



Kërkesat e shumta për të pesë trajnimet e licencuara kanë bërë që stafi qendror i SBASHK-ut të organizojë një aktivitet tre ditor me qëllim të përgatitjes së një numri trajnerësh, të cilët do të angazhohen bashkë me trajnerët e tanishëm për rrjedhën e mbarë të trajnimeve që do të vazhdojnë të organizohen edhe tani e tutje. Koordinator i për organizim të brendshëm Ymer Ymeri bashkë me stafin qendror kishin bërë angazhimet e duhura dhe ky aktivitet tre ditor doli i suksesshëm falë edhe angazhimit të gatishmërisë së prof. dr. Bardh Rugova, prof.dr. Hysen Sogojeva, prof.dr. Atdhe Hykolli, mr. Blerta Blakaj dhe trajnerëve të ... (faqe 4)

Përfaqësuesit e SBASHK-ut u takuan me kryetarin e Skenderajt Bekim Jashari

### Respekt i ndërsjellë për angazhime të përbashkëta



Për të parë nga afër gjendjen aktuale... (faqe 7)

Vizitë në Drejtorinë Arsimore të Mitrovicës

**SBASHK uron drejtorin e DKA-së Ismet Ferizi**



Krahas takimeve të shumta me përfaqësues të... (faqe 8)

Bisedë me disa prej veteranëve të SBASHK-ut

**Krenar dhe sot e gjithmonë me SBASHK-un**



*Për të shprehur respektin e lartë e meritë për... (faqe 3)*

Përfaqësuesit e SBASHK-ut u takuan me rektorin prof.dr. Naser Sahiti

### Gatishmëri për angazhime të përbashkëta



Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj i shoqëruar nga ... (faqe 5)



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës  
The Union of Education, Science and Culture

## Editorial

### U shpalosen kujtimet nëpër vite e dekada

Në rininë e tyre ishin përcaktuar për misionin e shenjtë



Kanë punuar me vite e dekada në arsim. Kanë kaluar nëpër furtuna në mbrojtje të arsimit shqip nga sulmet e pushtuesit serb në vitet e 90-ta. Krahas punës arsimore e edukative këta njerëz u angazhuan që në fillim edhe në veprimtaritë e SBASHK-ut. Janë këta nga themelartë e kësaj sindikate, që u përball suksesshëm me sfidat dhe krijoi emër të respektuar.

SBASHK-u për të treguar se nuk i harron veprimtarët e vetë organizoi një aktivitet tre ditor me ta. U takuan edhe një herë kryetarët e parë të nivelit komunal sindikal dhe koordinatorët, që bartnin zërin e SBASHK-ut nëpër komuna në kohët e vështira të okupimit dhe në vitet e para të pasluftës. Ky aktivitet nuk ishte thjeshtë një shëtitje, po u kthye në tryeza punë e përkujtimi. Këta veprimtarë me emocione, e shpesh të përmalluar, shpalosnin kujtime për rrugëtimin e SBASHK-ut nëpër dekada dhe ndjeheshin krenar. Pleqëria hetohej të ta se kishte lënë gjurmë, por hetohej edhe gjallëria dhe respekti i madh për SBASHK-un.

Edhe sot e gjithë ditën ata ndjejnë sfidat, momentet e vështira, por ndjejnë dhe u gëzohen edhe arritjeve e sukseseve të shumta të SBASHK-ut, të sindikatës që i bëri më të fortë, që i bëri unik e krenar.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

[www.sbashk-rks.org](http://www.sbashk-rks.org)

Mos hezitoni të na jepni sygjerrime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazeten e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

**Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)**

përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: [info@sbashk-rks.org](mailto:info@sbashk-rks.org)

Tel. +383 38 226 940





## Intervista

Bisedë me disa prej veteranëve të SBASHK-ut

### Krenar dje, sot e gjithmonë me SBASHK-un



*Për të shprehur respektin e lartë e meritë për punë dhe përkushtimin e tyre nëpër vite e dekada në*

*misionin e shenjtë të mësuesit dhe në aktivitetet e shumta sindikale në kohët plotë sfida, SBASHK-u ka organizuar një aktivitet falënderimi për veteranët e sindikatës sonë. Janë këta koordinatorët e dikurshëm dhe kryetarët e nivelit komunal sindikal. Shumica e tyre u bënë bashkë në këtë aktivitet, që shoqërohej me shpalosjen e kujtimeve për vitet e dekadat e shkuara, por nuk mungonin as rrëfimet e ngjarjeve të dikurshme, që shoqëroheshin aty e këtu me një humor të lehtë. Në këtë numër të gazetës sonë po shkëpusim fragmente të bisedave me disa prej këtyre veteranëve të SBASHK-ut.*

#### Bislim Behrami

E falënderoj SBASHK-un për këtë aktivitet respekti. U takuam ne kolegët e vjetër dhe takimi me bëri që të kujtoj kohët e shkuara dhe të harroj për këto qaste peshën e pleqërisë dhe tekat e sëmundjeve, që sjell ajo. Gëzohem që nuk na kanë bashkuar vetëm për të ndenjur kot, por krenohem që edhe tani sindikata jonë po kërkon këshilla e ide për të punuar pastaj Planin strategjik. U përmallova pse nuk janë të gjithë të ftuari këtu, por kështu e ka jeta. Më thanë se disa janë keq me shëndetin e disa nuk kanë mundur të vijnë për ndonjë shkak tjetër. Krenohem dhe ndihem mirë se SBASHK-u nuk po i harron veprimtarët e vet. Uroj të vazhdojë kjo traditë e mirë.

#### Sadik Shala

Jam krenuar gjithmonë me angazhimet dhe arritjet e SBASHK-ut. Edhe pas pensionimit i vizitova shpesh këta njerëz që me tërë mundësitë po angazhohen në realizimin e kërkesave të anëtarësisë. SBASHK-u ka shënuar e po shënon arritje të mëdha dhe kjo na bën të

ndjehemi krenar. Ne veteranët e sindikatës përcjellim me vëmendje situatën aktuale dhe ndajmë stresin e sfidat me stafin qendror dhe me gjithë punëtorët e arsimit. Krenohem që nuk na kanë harruar dhe po ndjehemi mirë që edhe tani po kërkojnë dhe po respektojnë idetë e këshillat tona.

#### Hakif Peci

Ky aktivitet m'i ktheu kujtimet për kohët e kaluara në procesin mësimor dhe në aktivitete sindikale. Arsimi shqip kaloi nëpër kohë të vështira dhe në plot furtuna, por ishte uniteti dhe bashkëpunimi që na forcoi dhe i tejkaluam gjithë ato vështirësi. Jam krenar që isha dhe , disi, mbetem anëtarë i SBASHK-ut, i kësaj sindikate që ka shënuar e po shënon rezultatet të shumta në shërbim të anëtarësisë.

#### Ibish Maksuti

Ky është një moment i veçantë për mua. U takova e bashkëbisedova me të gjithë veteranët dhe kujtuam bashkë kohët e kaluara dhe momente të vështira. Biseduam edhe për jetën e kaluar në arsim dhe për gjithë angazhimet që kemi bërë në shërbim të edukimit të brezave nëpër vite e dekada. Ndjehemi mirë që , që përveç dëshmisë se nuk na ka harruar SBASHK-u po organizohen takime pune dhe po dëgjohen me vëmendje vlerësimet dhe idetë tona.

#### Murat Kryeziu

SBASHK-u u themelua si kërkesë e kohës në vitet e vështira të Kosovës dhe arsimit shqip. Të bashkuar arritem të përballemi me sfidat dhe realizuam mision tonë të shenjtë ne ruajtjen e arsimit dhe shkollës shqipe. SBASHK-u vazhdoi rrugëtimin në përballje me sfidat duke shënuar suksese të shumta në shërbim të anëtarësisë. Ndjehem i lumtur mes kolegëve të mij , që janë veprimtarë të hershëm të sindikatës onë nga e tërë Kosova. Do të jemi gjithmonë pjese SBASHK-ut.

## Gjatë muajit

Një aktivitet i veçantë i SBASHK-ut

### Përgatiten kuadro të reja për trajnerë

Kërkesat e shumta për të pesë trajnimet e licencuara kanë bërë që stafi qendror i SBASHK-ut të organizojë një aktivitet tre ditor me qëllim të përgatitjes së një numri trajnerësh, të cilët do të angazhohen bashkë me trajnerët e tanishëm për rrjedhën e mbarë të trajnimeve që do të vazhdojnë të organizohen edhe tani e tutje.



Koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri bashkë me stafin qendror kishin bërë angazhimet e duhura dhe ky aktivitet tre ditor doli i suksesshëm falë edhe angazhimit e gatishmërisë së prof. dr. Bardh Rugova, prof.dr. Hysen Sogojeva, prof.dr. Atdhe Hykolli, mr. Blerta Blakaj dhe trajnerëve të tjerë për trajnimet “ Mësimdhënia e gjuhës shqipe dhe letërsisë shqipe për ciklin fillor dhe të mesëm”, “Udhëheqja dhe planifikimi strategjik në Arsimin Parauniversitar”, “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqjen efektive të dialogut social”, “Edukimi medial dhe roli i tij në zhvillimin shoqëror dhe demokratik” dhe “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”. Pjesë e këtij aktiviteti janë bërë edhe shefi i Kabinetit të Ministrit Likaj, z. Gëzim Berisha, Këshilltari i lartë Enver Osdaudaj dhe kryetari i Këshillit Shtetëror për Licencimin e Mësimdhënësve Osman Beka.



Në hapje të këtij aktiviteti të veçantë kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj ka përshëndetur pjesëmarrësit dhe ka lavdëruar angazhimin e koordinatorit Ymeri dhe stafit qendror duke shprehur respekt të lartë edhe për për profesorët e nderuar Rugova, Sogojeva, Hykolli, Blakaj dhe Kastrati, të cilët do të bartin përvojat e tyre te pjesëmarrësit duke i përgatitur mirë ata që të kenë sukses para një sfide të re duke pranuar detyrën që të mbajnë trajnime me kolegët kudo në Kosovë dhe do ta përfaqësojnë SBASHK-un në mënyrë të denjë.



Këshilltari i lartë i Ministrit Likaj, z. Enver Osdaudaj në fjalën përshëndetëse ka përgëzuar SBASHK-un për këtë aktivitet të qëlluar dhe për gjithë angazhimet në shërbim të anëtarësisë dhe arsimit në tërësi. Ai ka kujtuar se me angazhime të përbashkëta mund të arrihen suksese të vazhdueshme.

Kryetari i Këshillit Drejtues për Licencimin e Mësimdhënësve z. Osman Beka, i cili ka folur për rëndësinë e trajnimeve në ngritjen e cilësisë dhe ka lavdëruar përkushtimin e SBASHK-ut duke u shprehur për bashkëpunim të sinqertë e të vazhdueshëm në shërbim të arsimit.





Me pjesëmarrësit e këtij aktiviteti ka bashkëbiseduar edhe Gëzim Berisha, shëf i kabinetit të Ministrit Likaj. Ai duke sjellë përshëndetjet e Ministrit Likaj ka deklaruar se do të vazhdohet me bashkëpunimin në shërbim të arsimit duke qenë të sigurt se çështjet nga punëtorët e arsimit do të zgjidhen me dialog dhe angazhim të përbashkët.



Pas kësaj koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri ka dhënë sqarime për rrjedhën e këtij aktiviteti dhe për punën e përkushtimin që do të bëhet në të pesë grupet e ndara sipas trajnimeve.



Profesorët e nderuar Rugova, Sogojeva, Hykolli, Blakaj dhe Kastrati kanë vazhduar pastaj angazhimet në përgatitjen e trajnerëve të rinj për “Mësimdhënia e gjuhës shqipe dhe letërsisë shqipe për ciklin fillor dhe të mesëm”, “Udhëheqja dhe planifikimi strategjik në Arsimin Parauniversitar”, “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqjen efektive të dialogut social”, “Edukimi medial dhe roli i tij në zhvillimin shoqëror dhe demokratik” dhe “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” dhe në pjesën përmbyllëse kanë dhënë vlerësime për arritjet duke u shprehur se është vërejtur të pjesëmarrësit përkushtimi dhe gatishmëria për t’u dëshmuar kudo në Kosovë si trajnerë për trajnimin gjegjës.



Përfaqësuesit e SBASHK-ut u takuan me rektorin prof.dr. Naser Sahiti

## Gatishmëri për angazhime të përbashkëta

Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj i shoqëruar nga kryetari i Kuvendit të sindikatës së Universiteteve të Kosovës Bardh Bardhi dhe kryetari i sindikatës së Universitetit të Prishtinës, prof. dr. Azem Kyçuku kanë vizituar Rektoratin e Universitetit të Prishtinës dhe janë takuar me rektorin prof. dr. Naser Sahiti.



Kryetari i Kuvendit të Sindikatës së Universiteteve të Kosovës Bardh Bardhi ka përgëzuar prof.dr. Sahitin për zgjedhjen në detyrën e rektorit e pastaj ka informuar për angazhimet e SBASHK-ut në shërbim të arsimit dhe në plotësimin e kërkesave legjitime të anëtarësisë.

Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj ka uruar rektorin për detyrën dhe ka shprehur bindjen se me angazhime të përbashkëta do të arrihet që përmes dialogut e bashkëpunimit të gjendet zgjidhje për kërkesat e anëtarësisë dhe do të punohet edhe në shërbim të arsimit të Kosovës.




Kryetari i Sindikatës së Universitetit të Prishtinës prof. dr. Azem Kyçyku ka shprehur bindjen se me angazhime të përbashkëta do të shënohen rezultate e suksese dhe se Sindikata e Universitetit të Prishtinës, por edhe Sindikata e Universiteteve përmes SBASHK-ut do të jenë të angazhuar e do ta ndihmojnë rektorin në përpjekjet për rrjedhën e mbarë të punës në Universitet dhe në angazhimet për arritjen e sukseseve sa më të larta të këtij institucioni të respektuar arsimor e shkencor.

Rectori prof. dr. Naser Sahiti ka falënderuar përfaqësuesit e SBASHK-ut për vizitën dhe ka shprehur respekt të lartë për angazhimet e kësaj sindikate në realizimin e kërkesave të anëtarësisë, por edhe për përpjekjet konkrete për ngritjen e vazhdueshme të cilësisë në tërë arsimin e Kosovës. Ai ka shprehur gatishmërinë për bashkëpunim dhe angazhime të përbashkëta në shërbim të zgjidhjes së kërkesave të arsyeshme të anëtarësisë dhe të rrjedhës së mbarë të punës në Universitet.


Vullnet e entuziazëm i mësimdhënësve për pjesëmarrje në trajnime

## Të gjithë shprehin respekt meritore për angazhimet dhe arritjet e SBASHK-ut

Vazhdojnë të arrijnë në SBASHK kërkesa të shumta nga mësimdhënësit anëtarë të SBASHK-ut për organizimin e trajnimeve. Koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri bashkë me stafin qendror, krahas angazhimeve të shumta, po vazhdojnë me angazhimin edhe për realizimin me sukses të këtij aktiviteti. Duke parë numrin e kërkesave ata kanë vazhduar të organizojnë trajnimet e radhës, të cilat filluan të shtunën e 17 tetorit për të vazhduar të dielën, të hënën dhe të martën.




Pjesëmarrësit bazuar në vullnetin e tyre janë ndarë në 8 grupe në trajnimet "Edukimi medial dhe roli i tij në zhvillimin shoqëror dhe demokratik" me trajnerët Sami Shala e Hysen Hyseni, pastaj në trajnimin "Forcimi i kapaciteteve për udhëheqjen efektive të dialogut social" me trajnerët Safet Beqiri e Ramadan Gashi, në trajnimin "Udhëheqja dhe planifikimi strategjik në Arsimin Parauniversitar" me trajnerët Hysen Sogojeva e Jehona Oruçi dhe në trajnimin "Mësimdhënia e gjuhës dhe letërsisë shqipe për ciklin fillor dhe të mesëm" me trajnerët Atdhe Hykolli e Pranvera Haziri.






Të dielën , në ditën e dytë të trajnimit, duke u kyçur në secilin grup, ka bashkëbiseduar me pjesëmarrësit kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj. “Ju shpreh respekt meritore juve dhe gjithë kolegëve tanë kudo në Kosovë për përkushtimin në misionin e tyre të shenjtë të edukimit e arsimimit të brezave në këto kushte të vështirësuar nga pandemia. Shpreh respekt edhe për angazhimin e trajnerëve dhe përkushtimin e angazhimin e koordinatorit për organizim të brendshëm Ymer Ymeri dhe stafit qendror në realizimin e kërkesave të anëtarësisë dhe për kontributin në rrjedhën e mbarë të trajnimeve”, është shprehur kryetari Jasharaj, i cili pastaj u është përgjigjur edhe në pyetjet e pjesëmarrësve.



Koordinatori për organizim të brendshëm në SBASHK, Ymer Ymeri ka bashkëbiseduar me pjesëmarrësit dhe trajnerët duke sqaruar çështje që ndërlidhen me trajnimet dhe rrjedhën e tyre .

Trajnerët dhe pjesëmarrësit në kuadër të bashkëbisedave janë shprehur të kënaqur me rrjedhën e trajnimeve dhe kanë vlerësuar lart angazhimet e SBASHK-ut si zë i vetëm dhe i fuqishëm i gjithë të punësuarve në sektorin e arsimit, shkencës dhe kulturës të Kosovës.



Përfaqësuesit e SBASHK-ut u takuan me kryetarin e Skenderajt Bekim Jashari

## Respekt i ndërsjellë për angazhime të përbashkëta

Për të parë nga afër gjendjen aktuale të institucioneve arsimore në tërë Kosovën, përfaqësuesit e SBASHK-ut Rrahman Jasharaj, koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri dhe zyrtari ligjor Blendor Shatri e kanë nisur me agjendën e vizitave nëpër komunat e Kosovës. Vizitën e parë e kanë bërë në komunën e Skenderajt dhe fillimisht kanë zhvilluar një bashkëbisedë me drejtorin e arsimit Bekim Latifi dhe kryetarin nivelit komunal sindikal Ramiz Polaci për t'u informuar për gjendjen aktuale dhe rrjedhën e procesit mësimor në institucionet arsimore këtu.

Ata pastaj bashkërisht janë takuar me kryetarin e komunës së Skenderajt Bekim Jashari.

Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj ka falënderuar kryetarin e Skenderajt për gjithë angazhimet në shërbim të arsimit dhe plotësimit të kërkesave për punëtorët arsimor që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit të Kosovës.



”Agjendën e vizitave nëpër komuna e kemi nisur këtu për të shprehur respektin për përkushtimin e angazhimin e vazhdueshëm në shërbim të arsimit te drejtorit të DKA-së së Skenderajt Bekim Latifi, të kryetarit të nivelit sindikal komunal Ramiz Polaci, por për të shprehur respekt meritore edhe për ju”, është shprehur në fillim të takimit me kryetarin Bekim Jashari, kryetari i SBASHK-ut duke shtuar se po ndjehen krenar që po takohen e po bashkëbisedojnë

lirshëm me një pjesëtar të familjes embleme për gjithë shqiptarët.



Kryetari i Skenderajt Bekim Jashari ka shprehur respekt për angazhimet e SBASHK-ut dhe ka vlerësuar lart edhe bashkëpunimin në shërbim të arsimit te nivelit komunal të SBASHK-ut me DKA-në dhe me institucionet tjera në këtë komunë. Ai pastaj ka shtuar se do të vazhdohet me angazhimet dhe bashkëpunimin . Në kuadër të kësaj bashkëbisede është vlerësuar se në Skenderaj është gjendje stabile edhe në procesin mësimor dhe sepse për momentin edhe në kuadër të popullatës ka pak raste të prekjes me Covid dhe kjo ka bërë që edhe në institucionet arsimore gjendja të jetë e mirë dhe se procesi mësimor

është duke u zhvilluar si duhet falë përkushtimit të punëtorëve arsimor dhe nxënësve e prindërve që janë duke dhënë kontributin e tyre që gjendja të jetë e tillë.



Përfaqësuesit e SBASHK-ut bashkë me drejtorin e DKA-së dhe kryetarin e nivelit komunal sindikal kanë vizituar shkollën, që mban me krenari emrin e mësuesit dhe heroit të kombit Shaban Jashari dhe kanë parë nga afër se nxënësit dhe punëtorët arsimor këtu me punë e përkushtim e dëshmojnë krenarinë që shkolla e tyre mban emrin e kësaj figure të shquar të kombit tonë.

Vizitë në Drejtorinë Arsimore të Mitrovicës

## SBASHK uron drejtorin e DKA-së Ismet Ferizi



Për ta uruar për detyrën e drejtorit të DKA-së dhe për të bashkëbiseduar për angazhimet dhe situatën aktualer në arsimin e kësaj komune, kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj i shoqëruar nga zyrtari ligjor Blendor Shatri dhe kryetari i Kuvendit të Sindikatës së Arsimit parauniversitar të Mitrovicës Isa Ismajli ka vizuar Drejtorinë Arsimore të kësaj

komune dhe janë takuar me drejtorin e këtij institucioni Ismet Ferizi.

Kryetari Jasharaj ka përgëzuar z.Ferizi për emërimin në këtë detyrë “jam i bindur se ju i nderuari Ferizi si drejtor i DKA-së së Mitrovicës do të punoni me përkushtim dhe do të shënoni rezultate të shuma sepse fisnikëroheni nga përkushtimi në misionin e shenjtë të mësimdhënësit në edukimin e arsimimin e brezave dhe nga arritjet e shumta kur ishit drejtues i një institucioni në zë të arsimit të mesëm të lartë në Mitrovicë.”, ka deklaruar kryetari Jasharaj. Pas kësaj Drejtori i DKA-së së Mitrovicës z. Ferizi ka shprehur respekt për SBASHK-un dhe është ndjerë mirë për këtë vizitë. Zyrtari ligjor në SBASHK Blendor Shatri dhe kryetari i Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për Mitrovicën Isa Ismajli kanë përcjellë në këtë takim zërin e mësimdhënësve të



# Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

kësaj komune duke u ndalur të disa nga çështjet aktuale e për të cilat kanë apeluar te Drejtori që të ketë angazhime për zgjidhjen e tyre .

Drejtori Ferizi Ai ka treguar për angazhimet që janë duke e u bërë në mënyrë që procesi mësimor të


ketë rrjedhë të mbarë. Ai po ashtu ka treguar për gatishmërinë e bashkëpunimit në shërbim të anëtarësisë dhe në përpjekjet e përbashkëta për zgjidhjen e çdo çështjeje të ngritur.

Ndryshe u festua sivjet 5 Tetori-Dita Botërore e Mësuesit


## Mesazhe për 24 orë me radhë për unitet dhe solidaritet



Të 400 sindikatat anëtare të Internacionales së Arsimit (EI), mes tyre edhe SBASHK-u, kanë zhvilluar secila brenda mundësive të veta aktivitete përgatitore për të festuar 5 tetorin –Ditën Ndërkombëtare të Mësuesit e pas kësaj janë kyçur bashkërisht në një aktivitet 24 orësh nga larg organizuar nga EI.




Pikërisht me 5 tetor shumë nga veprimtarët sindikalë të SBASHK-ut ishin në programin 24 orësh për t'u bërë kështu pjesë e këtij aktiviteti bashkë me kolegët e tyre nga të gjitha vendet dhe kontinentet. Aty u janë drejtuar me mesazhe respekti për punën e angazhimin kryetarja e EI-së znj. Suzan Hopgood, sekretari gjeneral i EI-së David Edvards, kryetarja e Komitetit të Sindikatave të Arsimit të Evropës, Kristine Blouer, nga drejtorja e këtij Komiteti Suzan Flocken dhe ministra e njohës të arsimit.



Në kuadër të këtij aktiviteti SBASHK ka organizuar takime solemne me kryetarë të nivelit sindikal komunal e të universiteteve dhe me përfaqësues sindikal nga e tërë Kosova duke kujtuar se ky 5 Tetor arsimin te ne, në Ballkan , Evropë e në tërë botën e gjen në përballje me sfidat nga e kaluara, por edhe me sfidën mjaft të rëndë, që solli pandemia nga Covid 19.

Në këto takime është lexuar edhe mesazhi dhe letra publike e Komitetit të Sindikatave të Evropës



Me qëllim të forcimit të zërit sindikal

## SHSPZAP nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me SBASHK-un

Puna, përkushtimi, gatishmëria për t'u përballur me sfidat dhe arritjet e shumta në realizim të kërkesave të anëtarësisë kanë bërë që SBASHK-u të gëzojë respekt meritore edhe te sindikalistët nga sektorët tjerë. Një respekt të tillë ka shprehur edhe Sindikata e Punëtorëve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, e cila ka shprehur vullnetin për të lidhur marrëveshje bashkëpunimi me qëllim të forcimit të zërit sindikal, bartjes së përvojave dhe organizmit të aktiviteteve të përbashkëta sindikale.



Kërkesa e SHSPZAP është pranuar me kënaqësi nga SBASHK-u dhe në një ceremoni festive dhe pas një bashkëbisede mes dy palëve për situatën aktuale në të dy këta sektorë dhe për mundësitë e angazhimeve të përbashkëta sindikale është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit mes SBASHK dhe SHSPZAP nga kryetarët Rahman Jasharaj dhe Ramadan Gashi.

“SBASHK-u është shembulli më i mirë i organizmit sindikal dhe ne ndjehemi të nderuar për nënshkrimin e kësaj marrëveshje të bashkëpunimit. Jam i bindur se bashkëpunimi do të jetë i shoqëruar me plot rezultate dhe se anëtarët e sindikatës sonë do të marrin shumë përvoja nga SBASHK për organizimin dhe angazhimin sindikal. Në ceremoninë e nënshkrimit të kësaj marrëveshje krahas kryetarëve Jasharaj e Gashi kanë marrë pjesë edhe nënkryetarja e SBASHK Vjollca Shala e koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri dhe nënkryetari i SHSPZAP Muhamet Balaj.



Kryetari i SBASHK-ut Rahman Jasharaj është shprehur se duke nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi e duke përkrahur njëra-tjetrën sindikatat krijojnë një zë unik dhe një front të përbashkët të angazhimit në realizimin e kërkesave të anëtarësisë.

SBASHK-u nuk harroi udhëheqësit e dikurshëm sindikal

## Një aktivitet modest, por shumë domethënës

Janë ndjerë të emocionuar e krenar veprimtarët e hershëm kur kanë marrë ftesë nga sindikata e tyre për pjesëmarrje në një aktivitet modest, por shumë domethënës organizuar nga SBASHK. Ky aktivitet i ka bërë bashkë koordinatorët dhe kryetarët e dikurshëm të nivelit komunal sindikalë. Në këtë mënyrë SBASHK-u ka shprehur respekt meritore për angazhimet e tyre si koordinator dhe si kryetarë të niveleve komunale sindikale nëpër vite e dekada duke

dëshmuar kështu se ata nuk janë harruar, po kujtimi dhe respekti për angazhimin e tyre plot sakrifica zë vend meritore në faqet e historikut të SBASHK-ut. Në kuadër të këtij aktiviteti SBASHK-u në vazhdimësi dhe përgatitjes së Planit strategjik ka kërkuar idetë dhe kontributin e tyre në përgatitjen e këtij dokumenti, që përcakton dhe lehtëson rrjedhën e aktiviteteve në shërbim të anëtarësisë në periudhën 2021-2025.





“Këta njerëz janë të moshuar tani dhe po përballën me sfidat e moshës, por janë ndjerë krenar që SBASHK nuk i ka harruar dhe po kërkon edhe idetë e tyre për këtë dokument me rëndësi,” është shprehur kryetari Rrahman Jasharaj në hapje të këtij aktiviteti për të kujtuar kohët plot sfida kur koordinatorët dhe kryetarët e parë të nivelit komunal sindikal ishin angazhuar duke vënë themelet e një organizimi të fortë sindikal. "Ishin vitet e 90-ta kur SBASHK po dëshmohej me punë e sakrifica në ruajtjen e arsimit shqip nga furtunat e pushtesit dhe ju koordinatorët e parë dhe ju kryetarët të nivelit komunal sindikal po bartnit mbi supe gjithë atë aktivitet bashkë me kryetarin e parë Agim Hyseni dhe kryesinë e stafin e asaj kohe. Jam krenar që isha njëri nga ju", është shprehur me emocione kryetari Jasharaj.



Ai pastaj në shenjë respekti ka lexuar listën e pjesëmarrësve: Bislim Behrami, Haki Ymeri, Sefer Krasniqi, Ragip Qollaku, Hakif Peci, Hajriz Berisha, Sali Janova, Xhevat Haliti, Ahmet Gashi, Ibish Maksuti, Ajet Reshiti, Zeqir Krasniqi, Halil Idrizi, Taip Keçmezi, Murat Kryeziu, Sadik Shala, Lutfi

Mani, Elez Krasniqi, Rexhep Sadiku dhe Besnik Krasniqi.

Pjesëmarrësit e këtij aktiviteti falënderues e të punës gjatë tryezave të organizuara janë shprehur me emocione dhe kanë nisur me shpalosjen e kujtimeve nga vitet e kaluar plot sfida duke u ndalur në momente kyçe që i bëjnë të ndjehen krenar me sindikatën e tyre. Ata janë shprehur se mosha e shtyrë dhe tekat e kësaj moshe nuk i ndal ata të mendojnë për SBASHK-un duke u ndjerë krenarë për arritjet e shumta e duke ndjerë ende peshën e sfidave nëpër të cilat po kalohet. Pjesëmarrësit janë ndjerë keq pse sot e këtu nuk janë me ta kryetari i parë Agim Hyseni, nënkryetarët e parë Ali Shabanaj e Nediha Grapci, sekretari i parë i përgjithshëm Zenel Zeka, koordinatori Iljaz Qalaj, kryetari i nivelit komunal Mustafë Beqiri e ndonjë veprimtarë tjetër. Ata kanë dhënë edhe propozime e ide konkrete që do të jenë pjesë e Planit strategjik të SBASHK-ut për periudhën kohore 2021-2025.



Koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri ka shprehur respekt për veprimtarët e hershëm sindikal e pastaj ka shpalosur pjesë nga përmbajtja e punës së këtij takimi, kurse zyrtari ligjor Blendor Shatri ka bërë krahasime mes përmbajtjes së Planit strategjik aktual dhe objektivave që duhet të ketë plani i ri strategjik.

